



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr.04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Kornizë për bashkëpunim në Fushën e Mbrojtjes ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e përfaqësuar nga Departamenti i Mbrojtjes.
2. Obligohet Ministria e Mbrojtjes për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe të transkripteve të mbledhjeve: 247 dhe 249 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjeve: 246 dhe 248 elektronike/korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

- Emërohet Komisioni Ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese: Kryeinspektor Shëndetësor në Inspektoratin Shëndetësor, në këtë përbërje:
 - Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, kryesues;
 - Venera Çerkini, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtare;
 - Avni Kastrati, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, anëtar;
 - Haki Smajli, Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, anëtar; dhe
 - Rahman Zahiti, Ekspert i Jashtëm, anëtar.
- Obligohet Komisioni i lartpërmendur t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrat e Publik dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
- Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 10/233 i datës 27 nëntor 2024.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Funkcionimin e Zyrës për Administrimin e Pronës Publike në Zyrën e Kryeministrit.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenit 23 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Komisioni Ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim për Pozitën e Lartë të Kategorisë Drejtuese: Drejtor Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, në këtë përbërje:
 - 1.1. Venera Çerkini, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kryesuese;
 - 1.2. Fahrije Tërnavë, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme, anëtare;
 - 1.3. Avni Kastrati, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, anëtar;
 - 1.4. Haki Smajli, Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, anëtar; dhe
 - 1.5. Rrahman Zahiti, Ekspert i Jashtëm, anëtar.
2. Obligohet Komisioni i lartpërmendur t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr. 05/2024.
3. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 01/219 i datës 6 shtator 2024.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/251
Datë: 12.03.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 3, 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i projektit si më poshtë:
 - Mbyllja e Deponisë aktuale dhe realizimin e Deponisë Sanitare të Re në Pejë, Zona Kadastrale Lutogllavë, Komuna Pejë, sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
3. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, konform nenit 8 paragrafi 8. të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
4. Mjetet financiare për pagesën e shpronësimit dhe obligimeve tjera që mund të rrjedhin si rezultat i procesit të shpronësimit do të sigurohen nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Departamentin e Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës).
5. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Ekonomisë dhe Komuna e Pejës.

6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2025-2030 dhe Plani i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2025-2027.
2. Obligohen të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit koordinon dhe monitoron zbatimin e Strategjisë nga pika 1. e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 35, paragrafi 2. të Ligjit N.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që të ndryshohet Shtojca I: Të dhënat për ndarjen e Granteve të Përgjithshme, me qëllim të reflektimit të të dhënave të reja nga regjistrimi i popullsisë, të publikuara zyrtarisht nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në vitin 2024.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është tabela (shtojca I) me të dhënat e reja nga regjistrimi i popullsisë, publikuar zyrtarisht nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në vitin 2024.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca 1: Të dhënat për ndarjen e Granteve të Përgjithshme

Nr.	Komunat	Popullsia (Regjistrimi 2024)	Madhësia gjeografike (km2)	Komunitetet pakicë në Komunë	Komunat pakicë në Kosovë
1	Deçan	27,775	293.97	509	
2	Dragash	28,896	433.85	11,342	
3	Ferizaj	109,255	344.61	4230	
4	Fushë Kosovë	63,949	84.09	5548	
5	Gjakovë	78,699	586.64	6603	
6	Gjilan	82,980	391.84	2338	
7	Glogovc	48,079	275.63	43	
8	Hani i Elezit	8,533	83.13	16	
9	Istog	33,008	454.36	3116	
10	Junik	3,943	77.76	5	
11	Kaçanik	27,716	211.27	31	
12	Kamenicë	22,868	416.61	2310	
13	Klinë	30,503	309.02	1352	
14	Leposaviq	9,485	539.05	837	9,485
15	Lipjan	55,044	338.41	3183	
16	Malishevë	43,888	306.44	71	
17	Mamushë	5,607	10.94	387	5,607
18	Mitrovicë Jug	64,742	330.72	2049	
19	Novobërdë	4,493	203.98	692	
20	Obiliq	22,815	104.84	3573	
21	Pejë	82,745	602.58	7266	
22	Podujevë	70,975	632.59	904	
23	Prishtinë	227,466	523.14	4568	
24	Prizren	147,246	626.86	32762	
25	Rahovec	41,799	275.90	1308	
26	Shtërpecë	10,771	247.70	2691	10,771
27	Shtëme	24,308	134.42	775	
28	Skënderaj	40,664	374.37	275	
29	Suharekë	45,749	361.04	561	
30	Viti	35,566	269.69	243	
31	Vushtrri	61,528	344.85	681	
32	Zubin Potok	3,385	334.38	683	3,385
33	Zveçan	2,867	123.01	362	2,867
34	Graçanicë	18,486	122.42	9863	
35	Klllokot	3,041	23.39	1339	
36	Mitrovicë e Veriut	7,920	5.46	2326	7,920
37	Partesh	3,240	28.67	19	3,240
38	Ranillugë	2,481	77.62	132	2,481
TOTAL		1,602,515	10,905.25	114,993	45,756



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/251

Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 12, paragrafi 7. të Ligjit N.03/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen projektet kapitale, 1. palestra e gjimnastikës në Fushë Kosovë me kod 19244; 2. Qendra Historike e Prizrenit me kod 15111; 3. Shtëpia - kullë e Hajrullah Çantës, Prizren me kodin 19628; 4. Shkolla e vjetër e fshatit Mushnikovë me kod 19629; 5. Konservimi dhe restaurimi i Shtëpisë së Banimit të Kolë Pashkut, Stubëll, Viti me kod 19728 në organizatën buxhetore Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me kod 207, si projekte shumë-vjeçare, sipas Ligjit mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.
2. Obligimet e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit që mjetet buxhetore shtesë të nevojshme për të arritur totalin në vlerë prej 4,900,000.00€ (katër milion e nëntë qind mijë euro), (Palestra e gjimnastikës Fushë Kosovë 2,000,000.00€ (dy milionë euro); 2. Qendra Historike e Prizrenit 1,100,000.00€, (një milion e njëqindmijë euro); 3. Shtëpia - kullë e Hajrullah Çantës, Prizren 600,000.00€ (gjashtëqind mijë euro); 4. Shkolla e vjetër e fshatit Mushnikovë 400,000.00€, (katërqind mijë euro); 5. Konservimi dhe restaurimi i Shtëpisë së Banimit të Kolë Pashkut, Stubëll, 800,000.00€ (tetëqind mijë euro) për realizimin e projekteve për vitet fiskale përtej periudhës tre - vjeçare të mbuluar me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 t'i përfshijë brenda kufijve të vet buxhetor për secilin vit përkatës fiskal.
3. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/251

Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronës së paluajtshme të Ndërmarrjes ish Shoqërore "Kooperativa Bujqësore" Ropotovë e Madhe, Zona Kadastrale Dobërçan, që menaxhohet dhe administrohet nga Agjencia Kosovare të Privatizimit, shpronësimi i të cilës është i nevojshëm për realizimin e projektit: Varrezat e Fshatit dhe Fusha Sportive në Dobërçan, Zona Kadastrale: Dobërçan, Komuna Gjilan, sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda pesë (5) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Komuna e Gjilanit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/251
Datë: 12.03.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronave të paluajtshme ish Shoqërore, të menaxhuara dhe të administruara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, të cilat janë të nevojshme për realizimin e projekteve të mëposhtme të Komunës së Hanit të Elezit:
 - Rindërtimi i Fushës së Futbollit, Zona Kadastrale Hani i Elezit, Komuna e Hanit të Elezit;
 - Rregullimi i pronësisë për Fabrikën e Ujit, Zona Kadastrale Dermjak, Komuna e Hanit të Elezit;
 - Ndërtimi i Qendrës për Kulturë dhe Rini, Zona Kadastrale Hani i Elezit, Komuna e Hanit të Elezit;
 - Zgjerimi i rrugës pranë Terminalit Doganor, Zona Kadastrale Hani i Elezit, Komuna e Hanit të Elezit.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Komuna e Hanit të Elezit.

5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, 9, 10 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik të pronës së paluajtshme ish shoqërore N. Sh. "Industria e Tekstilit Integj" parcela kadastrale Nr.4945-7 dhe Objekti që menaxhohet dhe administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, shpronësimi i të cilës është i nevojshëm për realizimin e projektit: Çerdhe e fëmijëve, Hapësirë gjelbëruese dhe Infrastrukturë rrugore", Zona Kadastrale Gjilan, Komuna Gjilan, sipas tabelave bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij Vendimi Preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës.
3. Kundër këtij Vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky Vendim.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës), Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Subjekti Kërkues/Komuna e Gjilanit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 51 (2) të Ligjit Nr. 08/L-175 për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes së Përgjithshme të Sigurisë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Sllovenisë për Shkëmbim dhe Mbrojtje të Ndërsjellë të Informacionit të Klasifikuar.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr.04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare të Partneritetit për "Menaxhimin e Granat-kontratës të Asistencës Teknike me numër 2024/453-962 në kuadër të Programit për Bashkëpunim Ndërkufitar Shqipëri-Kosovë nën IPA II (2021 - 2027)", ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si partner dhe Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC), si partner lider.
2. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/251

Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr.04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Ndërkombëtare, përkatësisht Marrëveshjes së Partneritetit për Zbatimin e Prioritetit të Asistencës Teknike në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA III Mali i Zi-Kosovë (2021 - 2027), ndërmjet Autoritetit Menaxhues, përkatësisht Ministrisë për Çështje Evropiane të Republikës së Malit të Zi si partner udhëheqës dhe Strukturës së Bashkëpunimit Ndërkufitar të Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal të Republikës së Kosovës si partner.
2. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Bujqësi Organike.
2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Shëndetin e Bimëve.
2. Obligohet Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/251
Datë: 12.03.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 02/L-88 Për Trashëgiminë Kulturore, Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 400,000.00€ (katërqind mijë euro) në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kod 207, për zbatimin e programit Masat preventive, intervenime emergjente nëpër komuna të ndryshme.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi rialokohen nga nën-programi Mbrojtja, Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore me kod 81500 nga kategoria e shpenzimeve "Investime kapitale", përkatësisht nga projekti "Masat preventive, intervenime emergjente" me kod 12688 rialokohen në këto projekte, konform shumave të cekura:
 - 2.1. Konservimi dhe restaurimi i Shtëpisë së Xhafer Deves, me kod 13461, në shumë prej 166,000.00€ (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë euro);
 - 2.2. Rezidenca Ibrahim Rugova, me kod 15629 në shumë prej 30,000.00€ (tridhjetë mijë euro);
 - 2.3. Kalaja e Prizrenit, me kod 10093, në shumë prej 85,000.00€ (tetëdhjetë e pesë mijë euro);
 - 2.4. Intervenime emergjente-Kulla e Haxhi Buleshkaj, Istog, në shumë prej 10,930.00€ (dhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë euro);
 - 2.5. Intervenime emergjente-Kulla dhe Mulliri i Ali Bel Bicaj, Vrell-Istog në shumë prej 4,000.00€ (katër mijë euro);
 - 2.6. Konservim dhe restaurim-Koshi i Fevzi Hoxhës, Cërnice-Gjilan në shumë prej 16,000.00€ (gjashtëmbëdhjetë mijë euro);
 - 2.7. Intervenime emergjente-Shtëpia e Jelena Jakicit, Gjakovë, në shume prej 30,070.00€ (tridhjetë mijë e shtatëdhjetë euro);
 - 2.8. Intervenime emergjente-Mulliri i Babushit, Nerodime-Ferizaj, në shumë prej 28,000.00€ (njëzet e tetë mijë euro);
 - 2.9. Intervenime emergjente-Xhamia e Miftar Beçukut, Beçuk-Vushtri, në shumë prej 20,000.00€ (njëzet mijë euro);
 - 2.10. Intervenime emergjente-Mulliri në Biçec, Biçec-Kaçanik, në shumë prej 10,000.00€ (dhjete mijë euro).
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 19/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Kushtet e Bartjes së Pronësisë së Pronës Publike dhe Dhënia me Qira e Sendeve në Pronësi Publike.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 20/251

Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Mënyrën e Mbajtjes së Evidencës së Sendeve të Luajtshme dhe të Paluajtshme dhe e Regjistrimit të Sendeve në Pronësi Publike.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/251

Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr.04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Transferimin e Personave të Dënuar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 22/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr.04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështje Penale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 23/251
Datë: 12.03.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 4, paragrafi 2. të Ligjit Nr.04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Ekstradim ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë për ndërmarrjen e hapave konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 24/251
Datë: 12.03.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, paragrafi 12. të Ligjit Nr.08/L-332 mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 mars 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në shumë prej 1,308,320.00€, (një milion e treqind e tetë mijë e treqind e njëzetë euro), për realizimin e projekteve përmes marrëveshjeve me Trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve me kod 201, nga nën-programi "Marrëveshjet me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara" me kod 34100, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe ndahen si vijon:
 - 2.1. Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kod 205, ndahet shuma prej 200,000€ (dyqind mijë euro), në nën-programin "Mjedisi", me kod 50100, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere";
 - 2.2. Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me kod 205, ndahet shuma prej 208,320€ (dyqind e tetë mijë e treqind e njëzet euro), në nën-programin "Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit", me kod 50400, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere";
 - 2.3. Në Zyrën e Kryeministrit, me kod 104, ndahet shuma prej 300,000€ (treqind mijë euro), në nën-programin "Shërbimet e Statistikës", me kod 12400, në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe Shërbime";
 - 2.4. Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me kod 207, ndahet shuma prej 150,000 € (njëqind e pesëdhjetë mijë euro), në nën-programin "Mbrotjtja Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore" me kod 81500, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere";
 - 2.5. Në Ministrinë e Drejtësisë, me kod 215, ndahet shuma prej 200,000€ (dyqind mijë euro), në nën-programin "Departamenti për Integritet Evropian dhe KE ", me kod 27000, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
 - 2.6. Në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me kod 203, ndahet shuma prej 250,000€ (dyqind e pesëdhjetë mijë euro), në nën-programin "Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë", me kod 47400, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
3. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë